



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

NJOFTIM

PËR VEND VAKANT

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR PUNONJËS SHËRBIMI

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kërkon të punësojë në pozicionin **1 (një) punonjëse në administratë me detyrë “Punonjëse shërbimi”, gjinia femër**. Shkresa nr.120/2 prot., dt.26.01.2026 PP.

Bazuar në nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

NJOFTON:

Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **1 (një) vend “Punonjëse shërbimi”, gjinia femër** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Kushtet e përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë apo mos të ketë qënë nën hetim;

dh) ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore në marrëdhënie punë dhe/ose shërbim civil, që nuk është shuar sipas ligjit;

e) të ketë përfunduar arsimin e mesëm.

f) të jetë e gjinisë femër;

2. Kushtet e posaçme:

a) Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.

b) Të ketë aftësi komunikimi etik dhe profesional me publikun dhe shtetasit.

c) Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.

d) Të ruajë sekretin hetimor.

e) Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale si dhe sjellje etike.

f) Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si Microsoft: Word, Excel, PowerPoint, etj.

g) Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.

3. Krite të preferuara :

a) Të ketë eksperiencë të mëparshme pune në detyra që kanë pasur të bëjnë me komunikimin me qytetarët dhe me publikun, me rendin dhe sigurinë në institucione ose në institucione të tjera të sigurisë, mbrojtjes ose rendit publik.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, **deri në datën 12.02.2026 ora 10.00, këto dokumenta:**

a) Kërkesë për punësim.

b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.

c) Fotokopje e lejes së drejtimit.

d) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.

e) Diplomë e shkollës së mesme.

f) Dëshmi penaliteti.

g) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.

h) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.

i) Vërtetim mbi masat disiplinore në fuqi.

j) Vërtetim vendbanimi.

k) Vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore.

l) Referenca të mundshme nga punëdhënësi të mëparshëm.

m) Formular vetdeklarimi për gjendjen gjyqësore penale si dhe për kontakte me persona të dënuar/proceduar penalisht (formularët mund të tërhiqen në sekretarinë e prokurorisë).

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, **deri në datën 12.02.2026 ora 10.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.**

Konkurimi zhvillohet në dy faza :

Vlerësimi i dokumentacionit.

Intervista.

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kancelarja e kësaj Prokurorie, e cila pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe veçanta.

Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Pranimi do të bëhet bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat si dhe rezultatit të intervistës me secilin prej tyre.

Drejtuesi i Prokurorisë është organi në të cilin aplikuesit mund të paraqesin ankimimet/kundërshtimet e mundshme mbi çdo vendim të marrë në çdo fazë të konkurimit. Afati i ankimit është 5 ditë nga e nesërmeja e njoftimit.

Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **në datë 12.02.2026, nga ora 12.00 e në vijim.**

Pikëzimi i renditjes së aplikantëve është si vijon :

- Dokumentacioni 60 pikë.
- Intervista 40 pikë.

Konsiderohen të kualifikuar kandidatët që në përfundim të procesit kanë marrë më shumë se 70 pikë.

Njoftimi i datës së intervistimit konsiderohen të realizuar me anë të këtij njoftimi. Procedura e konkurimit bazohet në rregullat e vendosura në urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë. Kandidatët e interesuar mund të tërheqin një kopje të këtij urdhëri pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 054242674, ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al/Elbasan/

Po ashtu mund të drejtoheni edhe faqen Facebook : Prokuroria e Rrethit Elbasan ose Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Adresa e institucionit : Rruga “Koco Brisku”, lagjia “5 Maji” Elbasan

Prokurori i Medias: Ajkuna Anxhaku

e-mail: ajkuna.anxhaku@pp.gov.al

Kordinator për të Drejtën e Informimit: Alketa Kurmaku

e-mail: alketa.kurmaku@pp.gov.al

Nr. i gjelbër: +35542282084

Tel: +35542282028

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Paga : Klasa I, VKM 326.

PËRSHKRIMI I PUNËS SIPAS LIGJIT DHE RREGULLORES

Punonjësi i shërbimit duhet të zbatojë detyrat e përcaktuara në pikën 3.4 të nenit 36 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si dhe detyra të tjera të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë, Zv/Drejtuesi i Prokurorisë dhe kancelari.

Detyrat e punonjësit të shërbimit janë si më poshtë, por jo vetëm:

- a) të zbatojë me përpikmëri sigurimin e rregullit të brendshëm dhe ruajtjen e rendit në ambientet e Prokurorisë me mbështetjen e punonjësit të Policisë së Ruajtjes Fizike;
- b) të kërkojë nga i gjithë personeli zbatimin e rregullit dhe ruajtjen e rendit në ambientet e Prokurorisë;
- c) të lejojë hyrjen për nevoja pune e shërbimi, apo takime me punonjës të institucionit të personave të jashtëm, vetëm pas njoftimit të punonjësit dhe shoqërimit prej tyre të qytetarëve;
- ç) të regjistrojë në regjistrin përkatës emrin e personit të jashtëm, orën e hyrjes dhe emrin e pritësit;
- d) të kërkojë nga personat e jashtëm kalimin në aparaturën e kontrollit;
- dh) të mbajë armën (në rast se kanë) duke bërë regjistrimin përkatës të numrit të saj në regjister dhe kthimin pas takimit;
- e) të komunikojë me sektorët përkatës për ankesat që kanë bërë qytetarët duke i sqaruar ata vetëm sipas përgjigjes së marrë nga zyrat përkatëse, pa dhënë mendime e shpjegime personale;
- ë) t’u kërkojë personave që paraqiten për takim një dokument identifikimi, t’i pajisë me fletëhyrje, dhe në përfundim të takimit, t’u kthejë dokumentin e identifikimit;
- f) të zbatojë me përpikmëri orarin e shërbimit (shërbimi është me dy turne);
- g) të bashkëpunojë me punonjësit e ruajtjes së objektit për zbatimin me korrektësi të kërkesave të rregullores së brendshme dhe të kërkesave specifike të sigurimit fizik të objekteve shtetërore;
- gj) të zbatojë me përpikmëri grafikun e shërbimit dhe rregullat e marrjes dhe dorëzimit të tij;
- h) të mos lërë për asnjë moment vetëm vendin e shërbimit;
- i) të jetë i kujdesshëm me qytetarët dhe në rast konflikti të njoftojë kancelarin dhe kur gjykon se po cënohet rendi në institucion, kërkon ndihmën e punonjësit të policisë;
- j) të zbatojë detyrat specifike të dhëna nga eprorët për situata të ndryshme si festa, pushime apo situata gadishmërie;
- k) në rast fatkeqësish natyrore si zjarr, përmbytje, ndonjë difekt i rëndë elektrik etj., njofton zjarrfikësit, drejtuesin, kancelarin dhe vepron me iniciativë me fiksat apo hidrantet e ujit për mospërhapjen e rrezikut;
- l) të zbatojë detyra të tjera të dhëna nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe Kancelari.